



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE NË RUMANI  
VITI AKADEMIK 2023-2024**

Ministria e Sipërmarrjes dhe Turizmit- Departamenti i Tregtisë me Jashtë, njofton për fillimin e procesit të përzgjedhjes për 40 (dyzet) bursa studimi për vitin akademik 2023-2024.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të zotërojnë gjuhën rumune ose të regjistrohen për një vit përgatitor për gjuhën. Aplikimet duhet të dorëzohen online së bashku me dokumentacionin (<http://www.imm.gov.ro/ro/2023/03/30/acordarea-de-burse-de-studii-in-romania-pentru-cetatenii-straini-anul-universitar-2023-2024/>), brenda datës 30 Qershor 2023.

Afati i fundit përzgjedhës është me datë 31 Gusht 2023.

**Dokumentat e kërkuara për aplikimin online janë:**

1. Letër rekomandimi;
2. Formulari i aplikimit për bursë në Rumani – formulari MAT;
3. Formulari i aplikimit për bursë në Rumani – formulari ME;
4. Fotokopje e diplomave (diploma e shkollës së mesme ose ekuivalenti i saj, diploma bachelor, master, doktoraturë, nëse ka) dhe përkthimi i tyre i autorizuar në një nga gjuhët: rumune, angleze ose frënge. Nëse kandidati është në vitin e fundit të arsimit parauniversitar, në dosje duhet të dorëzohet një çertifikatë, e shoqëruar me një përkthim të legalizuar, që konfirmon fazën e përgatitjes dhe faktin që personi duhet të japë provimin e maturës në fund të vitit aktual shkollor. Nëse dosja e tij/saj përzgjidhet, kandidati që mbaron shkollën e mesme ose ekuivalentin e tij, i kërkohet të dorëzojë në ME/universitet një kopje të vërtetuar të diplomës së diplomimit dhe përkthimin e saj të legalizuar ose, sipas rastit, kopjen e certifikatës që vërteton faktin se është i diplomuar, me shënimin e datës në të cilën do të lëshohet diploma. Kandidatët që zgjedhin studimet pasuniversitare duhet të dorëzojnë të gjitha diplomat e marra më parë, në kopje të legalizuara dhe me përkthimin e tyre të legalizuar;
5. Transkriptet akademike, të vërtetuara nga autoritetet kompetente të vendit lëshues - fotokopje dhe përkthim i vërtetuar në një nga gjuhët rumune, angleze ose franceze. Në rastin e kandidatit të diplomuar parauniversitar, i cili do të zgjedhë të regjistrohet në arsimin universitar rumun, është e nevojshme të paraqesë kopjen e legalizuar të notave për çdo vit studimi. Për kandidatin që është në vitin e fundit të studimeve, paraqitet dëftesa e viteve të mëparshme dhe pjesa e parë e vitit shkollor aktual. Në rastin e kandidatit të diplomuar, i cili do të zgjedhë një formë të shkollimit pasuniversitar, është e detyrueshme të paraqesë kopje të legalizuara për të gjitha dokumentat e arsimit të lartë, përfshirë edhe transkriptet;
6. Deklarata e aplikantit se ai/ajo nuk ka përfituar një bursë tjetër nga Qeveria Rumune për nivelin akademik të kërkuar;

7. Certifikata e lindjes – fotokopje dhe përkthim i vërtetuar;
8. Kopja e dy faqeve të para të pasaportës (e vlefshme të paktën 6 muaj pas fillimit të programit të studimit të kërkuar);
9. Letërnjoftimi – fotokopje dhe përkthim i vërtetuar;
10. Certifikatë mjekësore në një nga gjuhët e mëposhtme: rumanisht, anglisht ose frëngjisht, e lëshuar deri në 90 ditë kalendarike përpara dorëzimit të dosjes;
11. CV;
12. 2 foto pasaporte.

Për informacion të mëtejshëm çdo kandidat mund të kontaktojë ne adresën e emailit: [burse2023@dce.gpv.ro](mailto:burse2023@dce.gpv.ro).